


**Pasqyrat Financiare përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar**

**Porsche Albania sh.p.k**

**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**


**Përgatitur nga:**

**Erinda Kanina  
(Drejtuese Financë)**




**Aprovuar nga:**

**Christoph Erlmoser  
(Drejtor i Përgjithshëm)**



**Gentian Bushati  
(Drejtor i Përgjithshëm)**



## Përmbajtja

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR .....	(i)
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR .....	1
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE .....	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL .....	3
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË .....	4
1.INFORMACION I PËRGJITHSHËM .....	5
2.PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL .....	5
3.VLERËSIME DHE GJYKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL .....	14
4.ZBATIMI I STANDARDEVE DHE INTERPRETIMEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA .....	15
5.STANDARDE DHE INTERPRETIME TË REJA .....	17
6.PËRCAKTIMI I VLERAVE TË DREJTA .....	18
7.MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR .....	19
8.MENAXHIMI I KAPITALIT .....	22
9.AKTIVE AFATGJATA JO-MATERIALE .....	23
10.AKTIVE AFATGJATA MATERIALE .....	24
11.AKTIVE ME TË DREJTË PËRDORIMI DHE DETYRIMET E QIRASË .....	26
12.INVENTARI .....	27
13.LLOGARITË E ARKËTUESHME .....	27
14.AKTIVE TË TJERA .....	28
15.MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTE TË TYRE .....	28
16.KAPITALI AKSIONAR .....	29
17.HUAMARRJET .....	29
18.PROVIGJIONE .....	30
19.LLOGARITË E PAGUESHME .....	30
20.DETYRIME TË TJERA .....	30
21.TË ARDHURAT NGA SHITJET .....	31
22.KOSTO E MALLRAVE TË SHITUR .....	31
23.SHPENZIME PERSONELI .....	31
24.FURNIZIME DHE SHËRBIME .....	32
25.TË ARDHURA TË TJERA/(SHPENZIME), NETO .....	32
26.TË ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE .....	32
27.TATIM FITIMI .....	33
28.ÇËSHTJET GJYQËSORE .....	33
29.PALËT E LIDHURA .....	34
30.NGJARJE TË KUSHTËZUARA DHE ANGAZHIME .....	35
31.NGJARJE PAS PERIUdhËS RAPORTUESE .....	35



## Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar aksionerit të Porsche Albania SH.P.K.:

### Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Porsche Albania SH.P.K. ("Shoqëria") më 31 dhjetor 2019, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

### Ne kemi audituar:

Pasqyrat financiare të shoqërisë përfshijnë:

- pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019;
- pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë politikat e rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

### Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

### Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

### Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e informacioneve të tjera. Informacionet e tjera përfshijnë Raportin e drejtimit të brendshëm dhe Raportin e ecurisë së veprimtarisë, (por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit).

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacionet e tjerat dhe ne nuk shprehim asnjë formë sigurie në lidhje me to.

### Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat

*Ky version i raportit tonë është përkthim i versionit origjinal të përgatitur në gjuhën Angleze. Ndërkohë, janë marrë të gjitha masat që përkthimi të jetë një paraqitje sa më e mirë e versionit origjinal. Megjithatë, në lidhje me çështjet e interpretimit të informacionit, këndvështrimet apo opinionet, versioni i raportit tonë në gjuhën origjinale ka përparësi ndaj këtij përkthimi.*

PricewaterhouseCoopers Audit SH.P.K.  
Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower 9/1, Tiranë, Shqipëri  
T: +355 (4) 2242 254, F:+355 (4) 2242 639, [www.pwc.com/al](http://www.pwc.com/al)

drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuadojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

---

### Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një anomali materiale. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalisë materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një anomali si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrolleve të brendshme që mund të jenë të nevojshme për hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionit mbi efikasitetin e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtimi.
- Arrijmë në një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtimi dhe, bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që sigurohet paraqitja e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.



PricewaterhouseCoopers Audit Sh.p.k.

PricewaterhouseCoopers Audit SH.P.K.


4 mars 2020

Tiranë, Shqipëri

Auditues Ligjor

Jonid Lamllari

A handwritten signature in black ink, appearing to be the name "Jonid Lamllari".




# Porsche Albania sh.p.k.


## Pasqyra e Pozicionit Financiar

(shumat janë të shprehura në Lekë)

	Shënime	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
<b>AKTIVET:</b>			
<b>Aktive Afatgjata:</b>			
Aktive Afatgjata Jo-Materiale	9	4,016,706	11,813,234
Aktive Afatgjata Materiale	10	616,912,250	628,462,550
Aktive me të drejtë përdorimi	11	105,521,532	-
		<b>726,450,488</b>	<b>640,275,784</b>
<b>Aktive Afashkurtra:</b>			
Inventarë	12	526,214,193	616,555,399
Llogari të arkëtueshme	13	33,979,092	67,414,699
Tatim fitimi i parapaguar	27	4,411,806	-
Aktive të tjera	14	13,047,402	8,830,169
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	15	32,229,797	28,455,685
		<b>609,882,290</b>	<b>721,255,952</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>1,336,332,778</b>	<b>1,361,531,736</b>
<b>KAPITALI:</b>			
Kapitali aksionar	16	707,911,000	707,911,000
Fitimi i pashpërndarë		86,830,050	100,192,670
<b>TOTAL I KAPITALIT</b>		<b>794,741,050</b>	<b>808,103,670</b>
<b>DETYRIMET:</b>			
<b>Detyrimet afatgjata:</b>			
Detyrime për qira	11	89,626,781	-
		<b>89,626,781</b>	-
<b>Detyrimet afatshkurtra:</b>			
Huamarrje	17	253,635,066	257,150,640
Provizgjione	18	32,130,876	32,466,840
Llogari të pagueshme	19	84,055,184	186,858,208
Tatim fitim për t'u paguar	27	-	4,055,648
Detyrimi i qirasë	11	15,894,750	-
Detyrime të tjera	20	66,249,071	72,896,730
		<b>451,964,947</b>	<b>553,428,066</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>		<b>541,591,728</b>	<b>553,428,066</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE &amp; KAPITALIT</b>		<b>1,336,332,778</b>	<b>1,361,531,736</b>

Pasqyrat Financiare janë aprovuar nga Drejtorët e Përgjithshëm të Porsche Albania sh.p.k më 3 shkurt 2020 dhe janë firmosur nga:

  
Christoph Ermoser  
Drejtor i Përgjithshëm

  
Gentian Bushati  
Drejtor i Përgjithshëm

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri në 35 të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## Porsche Albania sh.p.k.

### Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse (shumat janë të shprehura në Lekë)

	Shënime	Për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2018
Të ardhurat nga shitja	21	2,134,265,949	2,618,887,879
Kosto e mallrave të shitura	22	(1,714,596,457)	(2,167,149,100)
<b>Fitimi Bruto</b>		<b>419,669,492</b>	<b>451,738,779</b>
Shpenzime personeli	23	(154,050,401)	(156,811,891)
Furnizime dhe shërbime	24	(105,535,150)	(148,130,150)
Amorizim dhe zhvlerësim	9,10,11	(58,072,290)	(48,041,836)
Shpenzime të tjera operative, neto	25	(1,324,403)	(6,646,511)
<b>Fitimi operativ</b>		<b>100,687,248</b>	<b>92,108,391</b>
Shpenzime financiare		(5,816,591)	(7,996,062)
Të ardhura financiare		10,340,715	41,918,960
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>105,211,372</b>	<b>126,031,289</b>
Shpenzime për tatim fitim		(18,381,322)	(24,565,016)
<b>Fitimi për vitin</b>		<b>86,830,050</b>	<b>101,466,273</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse</b>		<b>86,830,050</b>	<b>101,466,273</b>

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet lexuar bashkë me shënimet në faqet 5 deri në 35, që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# Porsche Albania sh.p.k.

## Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

(shumat janë të shprehura në Lekë)

	Kapitali Aksionar	Fitimi i akumuluar	Totali
<b>Gjëndja më 1 janar 2018</b>	<b>707,911,000</b>	<b>66,665,957</b>	<b>774,576,957</b>
Fitimi neto i vitit	-	101,466,273	101,466,273
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	101,466,273	101,466,273
Shpërndarja e dividendevë	-	(67,939,560)	(67,939,560)
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2018</b>	<b>707,911,000</b>	<b>100,192,670</b>	<b>808,103,670</b>
<b>Gjëndja më 1 janar 2019</b>	<b>707,911,000</b>	<b>100,192,670</b>	<b>808,103,670</b>
Fitimi neto i vitit	-	86,830,050	86,830,050
Te ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	86,830,050	86,830,050
Shpërndarja e dividendevë	-	(100,192,670)	(100,192,670)
<b>Gjëndja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>707,911,000</b>	<b>86,830,050</b>	<b>794,741,050</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet lexuar bashkë me shënimet në faqet 5 deri 35 bashkëlidhur, që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



# Porsche Albania sh.p.k.

## Pasqyra e Flukseve të Parasë (shumat janë të shprehura në Lekë)

	Shënime	Për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2018
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga aktiviteti operativ</b>			
Fitimi i vitit:		86,830,050	101,466,273
<i>Rregullimet për:</i>			
Amortizim dhe zhvlerësim	9,10,11	58,072,290	48,041,836
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	13	(2,992,949)	(8,412,118)
Çregjistrimi i inventarit në vlerën neto të realizueshme	12	2,016,394	3,552,979
Të ardhura nga interesat	26	-	(2,142)
Shpenzime interesi	26	4,875,896	7,103,728
Shpenzime për tatime	27	18,381,322	24,565,016
<b>Fluksi i mjeteve monetare përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues</b>		<b>167,183,002</b>	<b>176,315,572</b>
Ulja e llogarive të arkëtueshme		36,428,556	4,125,006
(Rritja)/Ulja e aktiveve të tjera		(4,217,232)	25,225,407
Ulja e inventarit		90,141,618	14,600,802
(Ulja)/Rritja e llogarive të pagueshme		(102,803,024)	42,451,253
Ulja e provigjioneve		(335,963)	(1,909,254)
(Ulja)/Rritja e detyrimeve të tjera		(6,647,659)	13,388,613
<b>Flukse monetare të gjeneruara nga aktiviteti operativ</b>		<b>179,749,298</b>	<b>274,197,399</b>
Tatim fitim i paguar		(26,848,776)	(22,886,518)
Interesa të paguara		(4,875,896)	(7,103,728)
Interesa të arkëtuar		-	2,142
<b>Gjëndja neto e Flukseve Monetare të gjeneruara nga aktiviteti operativ</b>		<b>148,024,626</b>	<b>244,209,295</b>
<b>Mjete Monterare nga aktiviteti investues</b>			
Përdorime për blerje të aktiveve materiale	10	(13,595,620)	(7,294,920)
Të ardhura nga shitja e automjeteve	10	-	288,303
Përdorime për blerje të aktiveve jo-materiale	9	(4,047,701)	(1,008,369)
<b>Gjëndja neto e Flukseve Monetare të gjeneruara aktivitetin investues</b>		<b>(17,643,320)</b>	<b>(8,014,986)</b>
<b>Flukset e Mjeteve Monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues</b>			
Shpërndarje dividenti		(100,192,670)	(67,939,560)
(Pakësimi)/Shtimi i huasë		(3,515,574)	(191,172,035)
Flukse neto nga detyrimi i qirasë		(22,898,951)	-
<b>Gjëndja neto e Flukseve Monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues</b>		<b>(126,607,195)</b>	<b>(259,111,595)</b>
<b>Rritja/(Ulja) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre më 1 janar	15	3,774,111	(22,917,286)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre më 31 dhjetor	15	28,455,686	51,372,971
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre më 31 dhjetor</b>		<b>32,229,797</b>	<b>28,455,685</b>

Pasqyra e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet në faqet 5 deri në 35 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# Porsche Albania sh.p.k.

Shënimet shpjeguese të Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është shprehur ndryshe)

---

## 1. Informacion i Përgjithshëm

Porsche Albania sh.p.k ("Shoqëria") është themeluar në Shqipëri. Shoqëria është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e cila operon në Shqipëri dhe është krijuar me vendim gjykate nr. 33732, datë 27 qershor 2005 në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Numri i identifikimit të personit të tatueshëm është K51914014P. Numri mesatar i punonjësve për vitin 2019 është 74 (2018: 74).

Më 31 dhjetor 2019 dhe 2018, Shoqëria Mëmë e Porsche Albania sh.p.k. me kontroll të drejtpërdrejtë është Porsche Holding GmbH e regjistruar në Salzburg, Austri, dhe kontrollohet në mënyrë përfundimtare nga Volkswagen AG.

**Aktiviteti kryesor:** Aktiviteti kryesor i saj është shitja me pakicë dhe shumicë e automjeteve për pasagjerë dhe e pjesëve të këmbimit, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve.

**Adresa e regjistruar dhe vendi i biznesit:** Adresa e regjistruar e Shoqërisë është: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 3 Mëzez. Në 2015, Shoqëria ka regjistruar një adresë sekondare të ushtrimit të aktivitetit: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 7, Kashar.

**Monedha funksionale dhe e paraqitjes.** Këto pasqyra financiare janë të paraqitura në Lekë, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë, monedha e mjedisit primar ekonomik ku Shoqëria operon.

## 2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

**Baza e përgatitjes.** Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) sipas konventës së koston historike. Politikat kontabël të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare shpjegohen më poshtë. Këto politika janë aplikuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveçse kur është përcaktuar ndryshe.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon përdorimin e disa vlerësimeve dhe gjyqimeve kontabël të veçanta. Kërkohej gjithashtu që drejtimi të ushtrojë gjykimin e tij gjatë procesit të aplikimit të politikave kontabël të grupit. Rastet kur kërkohej një nivel më i lartë gjykimi apo kompleksiteti, ose kur supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare, shpjegohen në Shënimet shpjeguese 3.

**Transaksionet në valutë të huaj dhe gjëndjet.** Aktivitetet dhe detyrimet monetare janë përkthyer në monedhën funksionale të Shoqërisë, me kursin e këmbimit zyrtar të Bankës Qendrore të Shqipërisë ("BQSH") në fundin e periudhës përkatëse të raportimit. Fitimet dhe humbjet e këmbimit valutor që vijnë nga shlyerja e transaksioneve dhe nga përkthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare në monedhën funksionale përkatëse në kurset zyrtare të këmbimit të BQSH-së, njihen në fitim ose humbje si të ardhura ose kosto financiare, neto. Fitimet dhe humbjet e këmbimit valutor që kanë të bëjnë me huatë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse brenda 'të ardhurave ose kostove të financimit'. Të gjitha fitimet dhe humbjet e tjera të këmbimit valutor paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse brenda 'Të ardhurave / shpenzimeve të tjera'. Përkthimi në kursin e këmbimit të fundvitit nuk vlen për zërat jo monetarë që maten me kosto historike. Zërat jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë në një valutë të huaj, janë përkthyer duke përdorur kurset e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit në zërat jo monetarë të matur me vlerën e drejtë në një valutë të huaj regjistrohen si pjesë e fitimit ose humbjes së vlerës së drejtë.

# Porsche Albania sh.p.k.

Shënimet shpjeguese të Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është shprehur ndryshe)

## 2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

**Aktivet afatgjata materiale.** Aktivet afatgjata materiale janë paraqitur me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe minus humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet që i atribuohen drejtpërsëdrejti blerjes së artikujve. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës së drejtpërdrejtë, dhe çdo kosto tjetër që i atribuohet drejtpërdrejt sjelljes së aktivitetit në një gjendje pune për përdorimin e tij të synuar.

Kur pjesët e pronës dhe pajisjeve kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të veçantë (përbërës kryesorë) të pronës dhe pajisjeve.

Fitimi ose humbja nga pakësimet e pronës dhe pajisjeve përcaktohet duke krahasuar të ardhurat nga pakësimi me vlerën kontabël të pronës dhe pajisjeve dhe njihet neto brenda të ardhurave/shpenzimeve të tjera operative në fitim ose humbje. Kostot e mirëmbajtjes ditore të pronës dhe pajisjeve njihen në fitim ose humbje siç ndodhin. Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronës dhe pajisjeve njihet në vlerën kontabël të sendit nëse është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike do të rrjedhin në Shoqëri.

Në fund të çdo date të raportimit, Drejtimi vlerëson nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit të pronës, impianteve dhe pajisjeve. Nëse ndonjë tregues i tillë ekziston, Drejtimi vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si vlera më e lartë e drejtë e një aktivi minus kostot për shitje dhe vlerën e saj në përdorim. Vlera kontabël është zvogëluar në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin në masën që tejkalon tepricën e mëparshme të rivlerësimit në kapitalin neto. Një humbje nga zhvlerësimi i njohur për një aktiv në vitet paraprake shfuqizohet ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e aktivitetit në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot për shitje.

Zhvlerësimi llogaritet në baza lineare për të alokuar koston e tyre për vlerat e tyre të mbetura gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar dhe njihet në fitim ose humbje. Toka nuk zhvlerësohet. Normat vjetore të zhvlerësimit si më poshtë:

Ndërtesa	4%
Makineritë dhe pajisjet	10-20%
Pajisja Elektronike (EDP)	33%
Mobilje dhe instalime	20%
Automjete	20%

Toka nuk zhvlerësohet.

**Aktivet afatgjata jo-materiale.** Aktivet afatgjata jo-materiale të blera nga Shoqëria maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi, nëse ka. Amortizimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare të llogaritjes mbi jetën e aktiveve jo-materiale që nga data që aktiviteti është gati për tu përdorur. Normat vjetore të amortizimit si më poshtë:

Software	33%
Të drejtat e Shpërndarjes	15%

# Porsche Albania sh.p.k.

Shënimet shpjeguese të Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është shprehur ndryshe)

## 2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

**Aktive me të drejtë përdorimi.** Shoqëria ka marrë me qira zyrat. Kontratat mund të përfshijnë element që lidhen drejtpërdrejt me qira ose jo. Shoqëria ka shpërndarë koston e elementeve që lidhen me qiranë ose jo bazuar në çmimet e secilit element. Megjithatë, për qiratë e pasurive të patundshme për të cilat Shoqëria është qiramarrëse, ajo ka zgjedhur të mos ndajë komponentët e qirasë dhe jo-qirasë, në vend të kësaj I llogarit këto si një komponent të vetëm të qirasë.

Aktivet që janë marrë nëpërmjet qirasë vlerësohen në bazë të aktualizimit të flukseve të ardhshme dalëse.

Aktivet me të drejtë përdorimi maten bazuar në kosto të përbëre nga elementët e mëposhtëm:

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë,
- çdo pagesë të qirasë të bërë para ose në datën e fillimit, minus çdo stimul qiraje të marrë,
- çdo kosto fillestare të drejtpërdrejtë të kryer nga qiramarrësi,
- kostot për të kthyer aktivin në gjendjen e kërkuar nga kontrata e qirasë,

Aktivet me të drejtë përdorimi amortizohen me vlerën më të vogël mes jetës së dobishme aktivitetit dhe kohëzgjatjes së kontratës. Nëse ekziston një mundësi e arsyeshme për të blerë aktivin, e drejta e përdorimit të aktivitetit amortizohet bazuar në jetën e dobishme. Amortizimi i të drejtës së përdorimit të aktivitetit llogaritet në bazë lineare bazuar në jetën e dobishme. Jeta e dobishme si në vijim:

	Jeta e dobishme në vite
Toka	5
Ndërtesat	5

**Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare.** Aktivet jo-materiale që kanë një jetëgjatësi të dobishme të papërcaktuar ose aktive jo-materiale jo të gatshme për përdorim nuk janë subjekt i amortizimit dhe testohen çdo vit për zhvlerësim. Aktivet që i nënshtrohen zhvlerësimit dhe amortizimit rishikohen për zhvlerësim sa herë që ngjarjet ose ndryshimet në rrethanat tregojnë se vlera kontabël neto mund të mos jetë e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi njihet për shumën më të cilën shuma bartëse e aktivitetit tejkalon shumën e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë e drejtë e një aktiviteti minus kostot e nxjerrjes nga përdorimi dhe vlerës në përdorim. Për qëllime të përcaktimit të zhvlerësimit, aktivitetet grupohen në nivelet më të ulëta për të cilat ka hyrje kryesisht të pavarura të parave (njësi gjeneruese të parave). Zhvlerësimet paraprake të aktiveve jo-financiare (përveç emrit të mirë) shqyrtohen për ndryshime të mundshme në çdo datë raportimi.

**Inventari.** Inventarët maten me çmimin më të ulët dhe me vlerën neto të realizueshme. Kostoja e inventarëve bazohet në metodën specifike të identifikimit dhe përfshin të gjitha kostot e blerjes, kostot e konvertimit dhe kostot e tjera të shkaktuara në sjelljen e inventarëve në vendin dhe gjendjen e tyre aktuale. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, duke zbritur kostot e vlerësuar të kompletimit dhe shpenzimeve të shitjes. Në çdo fund të çdo date të raportimit, Shoqëria vlerëson nëse vlera kontabël e inventarëve të saj është e rikuperueshme për shkak të dëmtimit, vjetërsimit dhe/ose rënies së çmimeve. Nëse një artikull ose grup artikujsh në inventar është zhvlerësuar, Shoqëria njihet një humbje nga zhvlerësimi.

**Instrumentet financiare.** Shoqëria mban vetëm instrumente financiare jo-derivative. Instrumentet financiare jo-derivative përfshijnë mjetet monetare dhe ekuivalente të tyre, llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera. Shoqëria i klasifikon aktivitetet financiare jo-derivative në kategorinë "Huatë dhe arkëtimet".

Instrumentet financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohej më së miri nga çmimi i transaksionit. Një fitim ose humbje nga njohja fillestare regjistrohet vetëm nëse ekziston një ndryshim midis vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit i cili mund të dëshmohej nga transaksione të tjera të vëzhguara të tregut aktual të të njëjtit instrument ose nga një teknikë vlerësimi, inputet e të cilës përfshijnë vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhguara. Pas njohjes fillestare, një humbje e zbritshme për humbje të pritshme të kredisë (HPK) njihet për aktivitetet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

# Porsche Albania sh.p.k.

Shënimet shpjeguese të Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është shprehur ndryshe)

## 2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Instrumentet financiare të Shoqërisë maten me Koston e Amortizuar. Modeli i biznesit reflekton mënyrën sesi Shoqëria menaxhon aktivet për të gjeneruar fluks monetar – nëse objektivi i Shoqërisë është: (i) vetëm mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale (“mbajtja per mbledhje e flukseve monetare”) ose (ii) mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe të flukseve monetare që gjenerohen nga shitja e aktiveve (“mbajtja per mbledhje e flukseve monetare dhe shitje”) ose, nëse objektivi (i) dhe (ii) është jo i aplikueshëm, aktivet financiare klasifikohen si pjesë e modelit të biznesit “të tjera” dhe maten në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet financiare individuale (në nivel individual) bazuar në të gjithë evidencen përkatëse për aktivitetet që Shoqëria ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin individual në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga Shoqëria në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si kompensohen menaxherët.

Modeli i biznesit të Shoqërisë është vetëm mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale (“mbajtja per mbledhje e flukseve monetare”) vetëm.

Kur modeli i biznesit ka si objektiv mbajtjen e aktiveve per mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale ose mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe për të shitur, Shoqëria vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit (“VPPI”). Gjatë këtij vlerësimi, Shoqëria konsideron nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, pra interesi përfshin vetëm shumën për riskun e kredisë, vlerën kohore të parasë, risqet e tjera bazë të huadhënies dhe marzhin e fitimit.

Vlerësimi VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aseti dhe ai nuk rivlerësohet përsëri më pas.

Flukset e parave të Shoqërisë nga instrumentet financiare paraqesin vetëm pagesa të principalit dhe interesit në përputhje me përkufizimin e dhënë më lart.

**Zhvlerësimi i aktiveve financiare – Humbjet e pritshme të kredisë.** Matja e HPK pasqyron: (i) një sasi të paanshme dhe të ponderuar të probabilitetit që përcaktohet duke vlerësuar një sërë rezultatesh të mundshme, (ii) vlerën kohore të parasë dhe (iii) të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që është në dispozicion pa koston dhe përpjekjet e panevojshme në fund të secilës periudhë raportuese për ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme.

Shoqëria ka zgjedhur të masë humbjet e pritshme të kredisë për llogaritë e arkëtueshme në një shumë të barabartë me totalin e HPK përgjatë jetës së aktivitetit, duke përdorur një matricë provizionimi bazuar mbi norma të maturimit apo ditë vonesave.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre nuk janë zhvlerësuar në kredi pasi Shoqëria konkludon se zhvlerësimi i tyre është i parëndësishëm për shkak të natyrës afatshkurtër të aktivitetit financiar.

	Norma e humbjes	Rreziku specifik i vendit
- Të pa maturuara	1%	2%
- 1-30 ditë në vonesë	1.5%	2%
- 31-90 ditë në vonesë	2%	2%
- 91 deri në 180 ditë në vonesë	25%	2%
- 181 deri në 270 ditë në vonesë	50%	2%
- 271 deri në 360 ditë në vonesë	75%	2%
- mbi 360 ditë në vonesë	100%	2%

**Aktivitetet financiare – fshirja.** Aktivitetet financiare fshihen tërësisht ose pjesërisht, kur Shoqëria ka kryer cdo përpjekje për rimarrjen dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rimarrjen. Fshirja përfaqëson një rast të çregjistrimit.

# Porsche Albania sh.p.k.

Shënimet shpjeguese të Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është shprehur ndryshe)

## 2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

**Aktivet financiare – çregjistrimi.** Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) aktivet shlyhen ose të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet përfundojnë ose (b) Shoqëria ka transferuar të drejtat për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivet financiare ose ka hyrë në një marrëveshje likuidimi ndërkohë që (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiveve ose (ii) as nuk transferon dhe as nuk mban të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por nuk ruan kontrollin e këtyre aktiveve.

Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen

**Detyrimet financiare – kategoritë e matjes.** Detyrimet financiare klasifikohen si të matura në Koston e Amortizimit.

**Detyrimet financiare – çregjistrimi.** Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato likuidohen (d.m.th. kur detyrimi i specifikuar në kontratë paguhet, anulohet ose skadon).

**Kompesimi i instrumenteve financiare.** Aktivet dhe detyrimet financiare kompesohen dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompesimin e shumave të njohura dhe ekziston qëllimi për shlyerje në baza neto ose realizimin e aktivit dhe shlyerjen e detyrimit në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë kompesimi (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast mospagese dhe (iii) në rast të paaftësisë paguese ose falimentimit.

**Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre.** Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë paratë në arkë dhe depozitat rrjedhëse në banka apo investime të tjera likuide afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë subjekt i rrezikut të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe përdoren nga Shoqëria në administrimin e angazhimeve të saj afatshkurtra.

Mjetet monetare dhe ekuivalente me to mbahen në KA sepse: (i) ato mbahen për mbledhjen e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe këto flukse monetare kontraktuale reflektojnë VPPI (ii) dhe nuk janë të dizenuara me VDNFH.

**Llogaritë e arkëtueshme.** Llogaritë e arkëtueshme janë njohur fillimisht me vlerë të drejtë dhe në vazhdim mbarten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

**Llogari të pagueshme.** Llogaritë e pagueshme njihen kur pala tjetër përmbush detyrimet e saj të performances sipas kontratës dhe matet fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas mbahet me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

**Huatë.** Huatë njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur kostot e transaksionit dhe më pas mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

**Detyrime për qiranë.** Detyrimet për qiranë maten në bazë të aktualizimit të flukseve të ardhshme dalëse monetare. Detyrimet për qiranë përfshijnë vlerën aktuale të pagesave të mëposhtme:

- pagesa fikse, të pakësuara nga çdo stimul qiraje të marrë,
- pagesat variabël të qirasë të cilat varen nga një indeks ose normë, e matur fillimisht duke përdorur një indeks ose normë në datën e fillimit,
- shumat e pritshme për t'u paguar nga Shoqëria sipas vlerës së mbetur të garancive,
- çmimi i ushtrimit të opsionit të blerjes nëse Shoqëria është e sigurt për ushtrimin e këtij opsioni,
- pagesat e penaltiteve për përfundimin e qirasë, nëse Shoqëriamendon ta ushtrojë këtë opsion.

Shtyerja dhe përfundimi janë opsione të përfshira në një numër të konsiderueshëm të qirave për aktivet e Shoqërisë. Këto kushte përdoren për të maksimizuar fleksibilitetin operacional në administrimin e aseteve që Shoqëria përdor për operacionet e saj. Pjesa më e madhe e opsioneve të shtyerjes dhe përfundimit janë të ushtrueshme vetëm nga ana e Shoqërisë dhe jo nga qiradhënësi.

# Porsche Albania sh.p.k.

Shënimet shpjeguese të Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

*(Shumat janë të shprehura në Lekë përveçse kur është shprehur ndryshe)*

## 2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Opsionet e shtyerjes janë përfshirë në periudhën e qirasë nëse qiraja është në mënyrë të arsyeshme e mundur për tu shtyrë (ose për mos u përfunduar). Pagesat e qirasë që i përkasin periudhës së shtyerjes janë të përfshira në llogaritjen e detyrimit për qiranë financiare.

Pagesat për qiranë janë të aktualizuara duke përdorur normën e përcaktuar në kontratën e qirasë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, që është dhe rasti i qirave të Shoqërisë, përdoret norma e huamarrjes e cila është norma me të cilën Shoqëria do të duhej të merrte hua fonde për të blerë aktive me vlerë sa vlera e të drejtës së përdorimit të aktivitetit në një mjedis ekonomik të ngjashëm dhe me kushte apo kolateral të ngjashëm.

Për të përcaktuar normën e huamarrjes, Shoqëria:

- ku është e mundur përdor si fillim një financim të marrë nga Kompania, të përshtatur për të reflektuar ndryshimet nga momenti që financimi është marrë,
- përdor një normë interesi pa rrezik, e ndryshuar duke marrë parasysh rrezikun e kreditit,
- bën ndryshime specifike në lidhje me qiranë, për shembull termat, vendin, monedhën dhe kolateralin.

Norma rritëse e huamarrjes përcaktohet nga shoqëria mëmë për të gjitha degët e saj bazuar në specifikat lokale.

